



Ky botim u mundësua nga



ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË  
PREZENCA NË SHQIPËRI

Sheraton Tirana Hotel,

Kati i I-rë

Sheshi "Italia"

1010 Tiranë - Shqipëri

[www.osce.org/Albania](http://www.osce.org/Albania)

# TË NDRYSHËM POR TË BARABARTË

Të gjitha të drejtat e rezervuara © Presenca e OSBE-së në Shqipëri

Tiranë 2011

Ndërgjegjësimi i publikut për çështjet e diskriminimit ka përfaqësuar një aspekt të rëndësishëm të punës së Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Në veçanti, Prezenca ka dhënë mbështetje për hartimin e ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ka ndihmuar Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që nga krijimi i saj në vitin 2010.

Kjo broshurë e vogël vjen si rezultat i një veprimtarie të përbashkët të organizuar nga Prezenca dhe Zyra e Komisionerit për çështjen e diskriminimit nëpër shkolla. Broshura ka për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin për çështjet e diskriminimit, sidomos midis nxënësve dhe mësuesve. Ajo mund të shërbejë gjithashtu si një mjet për të ndryshuar të menduarit e fëmijëve dhe mësuesve në lidhje me diskriminimin.

Si pjesë e kësaj veprimtarie, nxënësve nga shkolla të ndryshme të Tiranës iu kërkua të shprehnin mendimet e tyre për diskriminimin me anë të pikturave apo shkrimeve. Punimet e tyre, të shfaqura publikisht gjatë një takimi të mbajtur në prill 2011, prezantohen tani në këtë broshurë.

## *Të dashur lexues,*

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj këtë broshurë të shkurtër që trajton çështjen e rëndësishme të diskriminimit. Kjo broshurë është rezultat i një aktiviteti të përbashkët të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Megjithatë, punimet e paraqitura këtu reflektojnë idetë e të rinjve mbi diskriminimin, të cilët dëshiroj t'i falënderoj për kontributin e dhënë.

Kjo broshurë është e veçantë për dy arsye: sepse është krijuar për të rinjtë dhe nga të rinjtë. Diskriminimi mund të fillojë që në një fazë të hershme, kur fëmijët dhe të miturit mund të jenë si viktimë edhe shkaktarë. Si rrjedhojë, lufta ndaj diskriminimit – që është edhe fokusi i kësaj broshure – duhet të fillojë sa më herët.

Ky botim nuk ka për qëllim të sigurojë leksione të gjata mbi diskriminimin. Përkundrazi, qëllimi është që ju të reflektoni mbi këtë çështje. Këto poezi dhe piktura ilustrojnë situata të cilat janë, fatkeqësisht, të njohura për të gjithë ne. Ato mund të sfidojnë perceptimet tona dhe të testojnë disa paragjykime. Madje mund të sjellin ndryshim në qëndrimin e njerëzve. Për këtë arsye, shpresoj që ky botim të jetë me interes dhe informues për ju.

**Ambasador Eugen Wollfarth**

*Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri*



## *Të nderuar lexues,*

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, më datë 04.02.2010, miratoi ligjin Nr. 10 221 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u krijua bazuar në këtë ligj si institucion i pavarur në ushtrimin e detyrës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër.

Duke e konsideruar si një domosdoshmëri rritjen e një brezi të ri pa paragjykitime dhe të ndërgjegjshëm për të ndërtuar një shoqëri të barabartë dhe jo diskriminuese, ligji ofron mbrojtje të veçantë në fushën e arsimit. Ky ligj jo vetëm ndalon diskriminimin në arsim, sidomos për grupe më të rrezikuara si përfaqësuesit e komunitetit rom, vajzat, personat me aftësi të kufizuara, por parashikon edhe masa të përkohshme për të nxitur barazinë në këtë fushë.

Dhe nëse ndjeni se jeni viktimë të sjelljeve diskriminuese, ky ligj ju krijon mundësi të mbronit të drejtën tuaj për barazi e mosdiskriminim. Vetë drejtuesit e shkollave kanë një rol të madh në ndërgjegjësimin e komunitetit të nxënësve, mësuesve dhe prindërve për mundësitë që u jep ky ligj për mbrojtjen e të drejtave të tyre, por edhe në zgjidhjen e rasteve të diskriminimit në shkolla.

Një mundësi tjetër është ankimi tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Shqyrtimi i ankimit pasohet nga rekomandime dhe në rast të moszbatimit të tyre vendosen edhe sanksione sipas parashikimeve ligjore.

Uroj që ky material t’ju japë informacione të dobishme dhe, mbi të gjitha, nëpërmjet punimeve të nxënësve në pikturë dhe krijime letrare, të bëjë të qartë se si diskriminimi konceptohet dhe përjetohet nga fëmijët.

**Irma Baraku**

*Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi*





## ● Jemi të barabartë

Ëndrra të shuara,  
fjalë pa kuptim,  
shpresa të mbaruara,  
kjo do të thotë diskriminim.

Sheh gjithandej,  
dhe gjithçka duket bosh.  
Dashurinë e botes don të rrëmbesh,  
por të mbetet veç të ëndërrosh.

Të gjithë të përbuzin,  
askush s'të buzëqesh,  
sheh të tjerët që lozin,  
por ty të duhet vetëm të jesh.

Flasin.. flasin pambarim,  
nuk dinë sa lëndojnë.

Të mungon i bukuri kujtim,  
ndaj të këqijat s'i harrojmë.

S'të pranojnë për atë ç'ka je,  
për mangësitë e tua,  
për besimin që ke,  
dhe me vete thua: "Këtë nuk e dua"!

Ndaj për mbrojtje luftoni,  
për të zhdukur çdo padrejtësi!  
Për të vuajtur nuk jetoni,  
ndaj kërkoni pak lumturi!

Për asgjë në botë,  
kurrë mos harroni,  
se jemi të barabartë,  
ndaj të gjithë pranoni!

**MARJETA POPSHINI**  
(SHKOLLA AHMET GASHI)

"JEMI TË BARABARTË". Me këtë vjershë unë kam shprehur ndjenjat e mia për individët e diskriminuar të cilët janë të nënvlerësuar, përbuzur dhe nuk u respektohen të drejtat. Gjithashtu, kam dashur t'u përcjell një mesazh këtyre personave në lidhje me kërkimin e së drejtës dhe lumturisë së jetës së tyre. Përveç mendimit dhe ndjenjave të mia, unë kam dhënë edhe mesazhin sa u përket këtyre njerëzve, një mesazh që shpresoj të merret parasysh nga të gjithë, se ne jemi të barabartë dhe këtë duhet ta pranojmë pa përjashtim të gjithë.

## ● Diskriminimi

*Dolëm nga një sistem komunist  
dhe një jetë të re filluam  
Rreth e qark botës po shkojmë  
dhe gjëra të reja po mësojmë  
Të mirën dhe të keqen e shikojmë  
dhe ata që na paragjykojnë  
jemi njerëz si çdo vend  
Punën duam dhe e bëjmë  
E njeriun se gjykojmë.*

*Një qëllim kemi në jetë  
Të jetojmë në harmoni  
Njëri-tjetrin mos të gjykojmë  
Por të kemi barazi.*

*Si i pasuri dhe i varfëri  
Si i ziu dhe i bardhi  
Jemi njerëz të kësaj toke  
Dhe çdo gjë duhet reciproke.*

**ESMERALDA SHABANI**  
(SHKOLLA AHMET GASHI)

Tek kjo poezi unë kam shprehur paragjykimet e bazuara të diskriminimit. Qëllimi i saj kryesor ka qenë vënëja në dijeni të gjithë atyre personave që diskriminojnë e që, në shumë mënyra kanë diskriminuar veten e tyre se ne jemi të ndryshëm nga natyra, por të barabartë sa u përket të drejtave që gëzojmë. Çfarëdolloj krijimi si: poezitë, pikturat apo prozat mbi diskriminimin, përçojnë mesazhin e përbashkët: “Jemi të ndryshëm por të barabartë”.

## ● Petale buzëqeshjesh

*Në sytë e mi pasqyruar  
Njëmijë ëndrra,  
Të ndrydhura,  
Të bëra copash,  
Deri në vdekje e kthim në iluzion.  
Në zemrën time shkruhet vuajtja  
E lagur,  
Nga mijëra pika loti.  
Në shpirtin tim qëndisur,  
ato ditë gëzimi...  
Tashmë të zverdhura.  
Shkalafiten nga tik-taku monoton  
i orës së ndryshkur  
Qëndroj te cepi i shkollës sime.  
Përpara më kalojnë me mijëra fytyra.  
Përpiqem t'i dhuroj buzëqeshje.  
Por më kot!  
Përpykjetë të dështuara miqësie!  
Petale buzëqeshjesh mbaj në duar,  
Ndaç zemrës sime i shtohet një tjetër vuajtje plus.*

**SINDI GJOSHE**  
(SHKOLLA EDITH DURHAM)

Poezia ime shpreh dhimbjen, vuajtjen dhe ndjenjat e të gjithë atyre personave, kryesisht fëmijëve të veçuar nga shoqëria. Shpresoj që të gjithë ne të vendosim dorën në zemër dhe t'i pranojmë këta persona ashtu siç janë, sepse të gjithë kemi lindur për të qenë të barabartë!

## ● KËRKOJ

*E dija botën të sinqertë  
Dhe diskriminimin jo pjesë e saj!  
Por kur zhgënjehesh, s'qenka e lehtë  
Të ulërij apo të qaj?!...*

*I pashë njerëzit aty  
Dhe hidhur më erdhi vërtetë  
Kur i varfri mohohet nga i pasuri  
Dhe i ziu nga i bardhi*

*Trishtimi im është ndër sy  
Kur njerëzit diskriminohen lehtë  
Dhe po të drejtohem Ty  
Mos e lë botën në tatëpjetë!*

*Ndaj kërkoj, sot po kërkoj...  
Nga ju një fjalë të ngrohtë  
Dhe nuk dyshoj, aspak s'dyshoj  
Që do të ndryshojë kjo botë.*

**ARLIND SUBASHI**  
(SHKOLLA E KUQE)

Me këtë poezi kam dashur të shpreh mesazhin: “Të gjithë janë po aq të rëndësishëm sa unë”.

## ● NJERËZIT E RRUGËS

*Kudo ku kaloj, një zë i mekur dëgjohet.  
Dy lek në jepni o njerëz, se Zoti për ju kujtohet  
Patetik i thellë, është zëri, dhimbje të madhe tregon.  
Si moment i braktisjes, shtrirë, leckosur, lypsari qëndron.  
Këmbët ekspozon pa ndrojtje, sakatë ato janë.  
Me përgjërëm mundohet, të prek shpirtrat tanë.  
Çoroditur nga stresi në kokë, shpirti trazohet sa më ska  
Lypsarë ndoshta një ditë, do rrimë në një rradhë me ta!  
Gjithkush le të mendohet, nga kjo gjëndja, si ata të dalin.  
Jemi të gjithë të barabartë, varfërië le ta ndalim...*

**BLERTA METHASANI**  
(SHKOLLA SHYQYRI PEZA)

Të qenit në një klasë me fëmijë rom dhe si presidente e shkollës, më ka bërë të jem më afër problemeve të tyre në këto kohë. Duke e parë nga afër dhimbjen e tyre, shpesh kam shkruar, dhe këto vargje më kanë dalë nga ai realitet i hidhur që më ngacmon mendimet orëve të mësimet. Edhe pse ne duam ti integrojmë, në sytë e tyre unë shpesh shoh trishtimin, vetminë, izolimin, e ndonjëherë mendoj se mos këto ndjenja kanë lindur bashkë me ta.



**IRIS KONI**  
(SHKOLLA EDITH DURHAM)

Shpesh në ambientet shkollore hasim diskriminime të mënyrave të ndryshme jo vetëm racore, por edhe diskriminimin ndaj pamjes së jashtme. Personat me trup të shëndoshë, me probleme ekonomike, ose me një paraqitje të jashtme të keqe nuk janë të mirëpritur në shoqëritë e sotme. Qëllimi i vizatimit tim është shprehja e diskriminimit të llojeve të ndryshme në një shkollë të zakonshme. Në plan të parë shfaqen disa vajza të cilat bëjnë tifo për një ndeshje futbolli e që, nuk pranojnë në skuadrën e tyre vajza të shëndosha, me defekte (si për shembull: me syze), vajza me pozitë të vështirë ekonomike (të diskriminuara nga veshja) apo madje dhe vajzat romë. Në pjesën e dytë të vizatimit shfaqet ndeshja e futbollit, ku djemtë romë janë në një skuadër më vete nga të tjerët. Ndarja në skuadra të ndryshme tregon diferencimin, por edhe luftën e brendshme shpirtërore që bëhet ndërmjet tyre.



**MELISA SHOTI**  
(SHKOLLA EDITH DURHAM)

Ajo që kam dashur, të them në këtë pikturë është diskriminimi nëpër shkolla për arsye të ndryshme. Ata ndihen të diskriminuar vetëm se janë ndryshe nga të tjerët. Nuk është e rëndësishme nëse besojnë në fe të ndryshme, nëse jemi të pasur apo të varfër, nëse jemi të bardhë apo me ngjyrë, nëse je invalid, etj. Mbi të gjitha ne jemi fëmijë. Kjo është ajo që ka rëndësi! Pse të mos shkojmë drejt së ardhmes së bashku!



**MEGI GJONI**  
(SHKOLLA EDITH DURHAM)

Në të gjithë botën ka fëmijë të zhytur në errësirën e diskriminimit.



**AMANDA HALA**  
(SHKOLLA EDITH DURHAM)

Në këtë pikturë unë kam paraqitur diskriminimin racial. Këtu unë kam vizatuar disa duar me ngjyra të ndryshme të cilat bashkohen në një pikë. Në qendër të pikturës kam paraqitur një shtëpi që simbolizon botën, e cila ka shumë njerëz brenda dhe pavarësisht ngjyrës apo mendimeve, ata janë të gjithë të barabartë, ndërsa rreth pikturës kam paraqitur shumë ngjyra të ndryshme, të cilat tregojnë paqen mes njerëzve. Kjo do të thotë se çdo njeri, pavarësisht ngjyrës, fesë apo mendimit të tij, është i barabartë me gjithë të tjerët.

**CLAUDIA MELEQI (SHKOLLA E KUQE)**

Ndryshe është mirë, i ndryshëm është bukur.

Himni i planetit Tokë: "Unë jam njeri".

**BLENDI CANAMERI (SHKOLLA E KUQE)**


**KLEA GJYZELI (SHKOLLA E KUQE)**

Njeriu është kurora e qenieve të gjalla.



Ngjyra tek njeriu është bujaria e natyrës që fal shumëllojshmëri.

**BLENDI CANAMERI  
(SHKOLLA E KUQE)**



Në punimin tim me djegie kam paraqitur 3 individë. Dy prej tyre janë në shkollë dhe tjetri ka një gjendje shumë të keqe ekonomike dhe nga vuajtja del për të lypur, por dy të shkolluarit e përqeshin, e tallin dhe në fund nuk i japin asgjë.

**GENTIAN GJONAJ  
(SHKOLLA AHMET GASHI)**



**GENTIAN GJONAJ**  
(SHKOLLA AHMET GASHI)

Në pikturën time kam paraqitur një plak të moshuar në një gjendje shumë të keqe ekonomike, i cili ka shumë nevojë.



**BEDRIE ZEKA**  
(SHKOLLA SHYQYRI PEZA)

Tema e diskriminimit, më ka tërhequr vëmendjen prej kohësh dhe sapo na u kërkua një ide e tillë, unë mendova të paraqisja këtë foto, ku bëhet fjalë për diskriminimin fetar, pasi më kishte ndodhur shpesh të shihja në ambiente publike apo stacione autobusi vajza dhe gra të mbulluara, që bëheshin epiqendra e bisedave të njerëzve përreth. I mendova ato vajza si në një burg me duart e mbërthyer tek hekurat e dritareve të tij, duke shpresuar lirinë për të zgjedhur.

**AURORA KULLOLLI**  
(SHKOLLA SHYQYRI PEZA)



Pamja ime flet për diskriminimin racor. Ideja e paraqitjes së kësaj vajze të kamur që po i jep një djali rom një libër, më lindi nga një situatë reale, kur ne shpesh në klasë iu japim shokëve tanë romë libra, stilolapsa, fletore, ushqime, që edhe ata të ndihen mirë e të ecin me hapin tonë. Nga ana tjetër unë doja që në një pamje të përmbledhja shumë lloje diskriminimesh si: atë racor, ekonomik, kulturor, etj.



**RESINA MEÇANI**  
(SHKOLLA  
SHYQYRI PEZA)

Në pikturën time kam dashur të shpreh idenë, se në të gjithë botën ka ngjyra dhe fe të ndryshme, por fëmijët kanë një emër të barabartë: “fëmijë” dhe janë të gjithë të njëjtë e të pafajshëm. Mesazhi që doja të përcillja ishte: “Kështu duhet të jenë edhe të rriturit”.



**ETJONA JAHO**  
(SHKOLLA  
SHYQYRI PEZA)

Unë kam paraqitur diskriminim etnik. Mesazhi im është: “Harta ka ndarje, vija, kufij, por njerëzimi duhet të jetë një. Për fëmijët në veçanti nuk duhet të ketë kufij në mendimet e tyre. Globi është një, bota është një, fëmijët e botës janë një”.



**KLEA ZAHARIA**  
(SHKOLLA  
BAJRAM CURRI)

Pika kryesore që më shtyu të bëj këtë vizatim ishte dëshira e madhe që barazia të mbizotërojë në botë.

**RAHELA KOTOLLAKU**  
(SHKOLLA  
BAJRAM CURRI)



Me pikturën time kam pasur parasysh që pavarësisht ngjyrës, racës, paraqitjes së jashtme, të gjithë duhet të jemi të barabartë para Zotit e ligjit.



**MEGI ZEQQ**  
(SHKOLLA  
BAJRAM CURRI)

Në atë pikturë është paraqitur një vajzë rome e lënduar nga mendimet se dikush do ta diskriminojë. Ajo i thotë STOP asaj jete të vuajtur dhe vendos të hapë një faqe të re në jetën e saj. Një jetë ku të gjithë janë të ndryshëm, por të barabartë.



Në pikturën time janë paraqitur dy shokë, njëri prej të cilëve është rom. Ata mirëkuptohen me njëri-tjetrin pavarësisht se janë të ndryshëm. Të gjithë jemi të ndryshëm, por të barabartë.

**KRISTIAN XHAFERAJ**  
(SHKOLLA  
BAJRAM CURRI)



**KLEA ZAHARIA**  
(SHKOLLA  
BAJRAM CURRI)

Pika kryesore që më shtyu mua të bëj këtë vizatim ishte dëshira e madhe që barazia të mbizotërojë në botë.



**MEGI NUSHI**  
(SHKOLLA  
BAJRAM CURRI)

Në pikturën time kam dashur të ndërthur shumë simbole, ku mbi të gjitha doja të transmetoja mesazhin: “Ne jemi të barabartë dhe diskriminimi nuk duhet të ekzistojë mes nesh”.



**HENEIDA GJUZI**  
(SHKOLLA  
GJON BUZUKU)

Te ky vizatim kam paraqitur katër njerëz, dy me ngjyrë dhe dy pa ngjyrë për të përcuar mesazhin se njerëzit nuk duhet të ndahen nga raca, ngjyra, gjinia apo besimet fetare. Kemi lindur në të njëjtin institucion. Në botë ka shumë paragjykime bazuar te diskriminimi racial. Në Shqipëri nuk duhet të ekzistojë diskriminimi racial, sepse jemi të gjithë të barabartë. Gabimi më i madh është ndarja e njerëzve në bazë të racës. Diskriminimin duhet ta shembim si një mal. “Ndal diskriminimin racial”!



**DENISA JONUZI**  
(SHKOLLA  
GJON BUZUKU)

Unë në vizatimin tim kam paraqitur martesën e dy individëve. Midis tyre ka lindur një dashuri e fortë, edhe pse ato janë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Në mendjen tonë nuk duhet të ekzistojë paragjykimimi ose diskriminimi racial. Meqenëse në këtë botë të gjithë kemi lindur të barabartë, atëherë mes nesh duhet të ekzistojë barazia dhe drejtësia. Në këtë botë të gjithë kanë të drejtat e tyre si në shkollë, ashtu edhe në familje, në shoqëri, etj. Kur dashuria midis dy personave është e fortë, ajo mund të thyjë edhe hekurin. Pse të mos thyjë edhe diskriminimin?

JEMI TE BARABARTE



**AMARILDA OSMANI**  
(SHKOLLA  
GJON BUZUKU)

“Jemi të ndryshëm, por të barabartë”

Të gjithë lindëm për një qëllim, ta jetonim jetën të barabartë. Të gjithë jemi njerëz, në venat tona rrjedh gjak, e kemi mënyra të ndryshme se si e konceptojmë jetën. Pse nuk duhet të jemi një shoqëri e madhe ku me larminë e ideve tona, ta bëjmë botën një vend ku fjala diskriminim nuk ka vend? T’i themi diskriminimit njëzëri se ai nuk bën pjesë në jetët tona.



**BOBAN ANASTASI**  
(SHKOLLA  
GJON BUZUKU)

Në këtë vizatim, kam dashur të shpreh një mesazh të shkurtër në lidhje me racizmin. Dy duar të shtrënguara, njëra pa ngjyrë dhe tjetra me ngjyrë, tregojnë se pavarësisht nëse njëri është një person me ngjyrë dhe tjetri pa ngjyrë, ata janë miq dhe jo si shumëkush që i përbuz personat me ngjyrë apo pa ngjyrë. Mesazhi që kam dashur të shpreh është: “Njerëzit, pavarësisht nga moshja, gjinia, traditat dhe në rastin konkret ngjyra, janë të gjithë të barabartë”.









KOMISIONERI PËR MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI  
Rr. "Sami Frashëri" Nr. 10, Kati II  
1019 Tiranë  
Telefon: + 355 4 243 1078  
Faks: + 355 4 243 1077  
E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

